



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kryetarja e Komunës

01nr 112-15619 2016

Dt: 16.03.2016

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 11,13 dhe 58.a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L-040, nenin 22 të Ligjit nr.03/L-204 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, lidhur me nenin 4 të Ligjit Nr. 04/L-100 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme Nr. 03/L-204, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë për Financa nr.5/2011, për procesin e ankesave të tatimit në pronën e paluajtshme, e në harmoni me Përfundimin e Bordit të Drejtorëve nr. 06-12359-11/1 me dt: 16.03.2016 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Bordi i Komunës së Gjakovës për shqyrtimin e ankesave të qytetarëve , të ushtruara ndaj faturave të tatimit në pronën e paluajtshme , në këtë përbërje:

1. Z. Zenel Shabani, kryesues i Bordit
2. Z. Ukë Komani, anëtar
3. Z. Bekim Syla, anëtar

2. Bordi Komunal do të shqyrtojë të gjitha ankesat e qytetarëve të Komunës së Gjakovës lidhur me faturat për tatimin në pronën e paluajtshme, duke vepruar në harmoni me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-204 i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-100 për tatimin në Pronën e Paluajtshme dhe Udhëzimit Administrativ të MF nr. 5/2011.

3. Mandati i Bordit Komunal për shqyrtimin e ankesave të qytetarëve të Komunës së Gjakovës është një vit, me mundësi të riemërimit edhe për një vit .

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

5. Vendimi iu dorëzohet:

- Anëtarëve të Bordit Komunal
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit

Kryetarja e Komunës

Znj. Mimoza Kusari-Lila

